

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria aci engineering shp.k. është regjistruar në Qendrën Kombëtare të regjistrimit në 09 Prill 2015. Veprimtaria e saj sot rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Administratori i shoqërisë është : z. Erblin Selimi

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë.

Ajo është regjistruar në Degen e Tatim Taksave Tiranë me NIPT L51609014F

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është Import Export, studime, projekte, në fushën elektroenergjitike.

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit ushtrimor është 19.

2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat financiare te Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtezuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.6 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme

2.7 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyre konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2025	2024
Euro/LEK	96.77	98.15
USD/ LEK	82.46	94.26
Pound/LEK	110.76	118.16

3.2 Instrumentat financiare

Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to maten mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e performancës.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material në përpjesëtim me periudhën e përdorimit gjatë atij viti. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre dhe informatike	Lineare	25%
Mobilje zyre	Lineare	20%
Mjete Transporti	Lineare	20%
Makineri, vegla pajisje pune, të tjera	Lineare	20%

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat nga kryerja e shërbimeve në përpjestim me fazën e përfundimit të shërbimit në datën e raportimit. Faza e përfundimit të shërbimeve vlerësohet mbi ecurinë e punëve të kryera

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese

3.7 Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përfshijnë të gjitha format e shpërbimit të dhëna nga Njësia Ekonomike në shkëmbim të shërbimit të kryer nga punonjësit. Njohja: Këto shpenzime njihen në momentin kur është kryer puna nga punonjësit, pavarësisht nga data e pagesës së tyre (parimi i konstatuar). Përbërja: Shpenzimet përfshijnë pagat bruto, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (pjesa e punëdhënësit), si dhe çdo përfitim tjetër afatshkurtër të lidhur me punësimin. Detyrimet: Kontributet e sigurimeve dhe Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi (TAP) mbahen dhe paguhen sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3.8 Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit përfshijnë shpenzime që lidhen me veprimtarinë normale të shoqërisë, por që nuk klasifikohen si shpenzime direkte të aktivitetit kryesor.

3.9 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të performancës nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative. Pagesat e qirase operative njihen në pasqyrën e performancës me metodën lineare përgjate periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së përfutur njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë periudhës së qirasë.

3.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin përfshin tatimin mbi të ardhurat e periudhës aktuale. Tatimi llogaritet mbi fitimin neto të rregulluar për qëllime fiskale (fitimi kontabël plus shpenzimet e pazbritshme minus të ardhurat e përjashtuara), duke aplikuar shkallët tatimore dhe normat në fuqi të parashikuara nga legjislacioni tatimor shqiptar. Ky shpenzim njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën raportuese.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyre mbi fitimin.

3.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura

Monedha: Lek

4 Shënimet Shpjeguese

		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
4 Mjete Monetare	Monedha		
Mjete monetare lekë	lekë	64,301,422	8,793,908
Mjete monetare euro	euro	47,088,024	67,581
Mjete monetare usd	usd	422,279	260,355
Mjete monetare pound	gbp	5,734,722	35,445,046
Totali		117,546,447	44,566,890
		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
5 Llogari të arketueshme tregtare	Monedha		
Klientë	lekë	510,922,649	737,395,318
Totali		510,922,649	737,395,318
		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
6 Të tjera llogari të arkëtueshme	Monedha		
Tatim mbi fitimin	lekë	-	472,703
Totali		-	472,703
		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
7 Te arketueshme nga debitore te ndryshem	Monedha		
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	lekë	28,033	73,470
Huadhenie pale te lidhura	lekë	99,031,000	-
Debitore të ndryshëm	lekë	1,987,170	-
Totali		101,046,203	73,470
		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
8 Inventar Mallra	Monedha		
Inventar i imët	lekë	89,637,361	220,619,312
Totali		89,637,361	220,619,312

9 Parapagime për porosi	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefë ne lekë	Vlefë ne lekë
Paradhenie per furnizim	lekë	-	12,132,517
Paradhenie per furnizim F.huaj	lekë	-	9,041,756
Totali		-	21,174,273

10 Shpenzime të shtyra	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefë ne lekë	Vlefë ne lekë
Shpenzime të periudhave të ardhme	lekë	305,019	1,370,514
Totali		305,019	1,370,514

11 Aktive financiare	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefë ne lekë	Vlefë ne lekë
Tituj pronësie ne njësi te tjera ekonomike	lekë	92,000,000	-
Totali		92,000,000	-

12 Aktive afatgjata materiale						31 Dhjetor 2025
Kosto	Toka	Instalime Pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Orendi informatike	Totali
Gjendja në fillim		7,613,521	63,038,149		6,261,281	76,912,951
Shtesa	23,193,600	711,284	7,910,999		186,240	32,002,123
Pakësime						-
Gjendja në fund	23,193,600	8,324,805	70,949,148		6,447,521	108,915,074
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja në fillim		4,737,451	35,723,954		4,423,359	44,884,764
Shtesa		764,714	7,867,074		573,462	9,205,249
Pakësime						-
Gjendja në fund	0	5,502,165	43,591,028		4,996,821	54,090,013
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	0	2,876,070	27,314,194		1,837,922	32,028,187
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	23,193,600	2,822,640	27,358,120		1,450,700	54,825,060

		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
20 Total kapitali	Monedha		
Kapitali i nënshkruar	lekë	100,000	100,000
Rezerva të tjera	lekë	538,910,759	637,782,829
Fitimi i ushtrimit	lekë	294,982,196	235,027,930
Totali		833,992,955	872,910,759

		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
21 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	Monedha		
Të ardhura nga shitjet	lekë	721,062,213	706,177,177
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	lekë	-	745,291
Totali		721,062,213	706,922,468

		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
22 Mallra të konsumueshme	Monedha		
Mallra të konsumueshme	lekë	-315,721,437	-367,003,832
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	lekë	-	-854,158
Totali		-315,721,437	-367,857,990

		31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefte ne lekë	Vlefte ne lekë
23 Shpenzime të personelit	Monedha		
Paga dhe shperblime	lekë	-23,289,663	-23,193,933
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	lekë	-3,397,358	-3,468,026
Totali		-26,687,021	-26,661,959

24 Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefëta ne lekë	Vlefëta ne lekë
Shpenzime energjie	lekë	-191,544	-188,590
Shpenzime kancelarie	lekë	-103,258	-136,767
Shpenzime zyre dhe pastimi	lekë	-4,625	-5,375
Shpenzime qiraje	lekë	-3,016,966	-3,060,138
Shpenzime mirëmbajtje riparime	lekë	-1,304,465	-1,743,678
Shpenzime siguracione	lekë	-1,054,928	-1,490,925
Shërbime konsulenca	lekë	-4,632,636	-2,700,301
Shpenzime të ndryshme	lekë	-2,396,781	-2,697,543
Transferime, udhëtime, dieta	lekë	-1,098,902	-2,645,758
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	lekë	-486,999	-528,317
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	lekë	-430,200	-227,993
Shpenzime karburant transport	lekë	-2,645,202	-2,911,817
Komisione bankare	lekë	-930,801	-405,655
Taksa dhe tarifa vendore	lekë	-317,617	-224,200
Shpenzime të tjera	lekë	-1,610,834	-567,498
Totali		-20,225,758	-19,534,555

25 Të ardhura Shpenzime financiare	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefëta ne lekë	Vlefëta ne lekë
Te ardhura Shpenzime kursi kembimit	lekë	-1,539,451	-4,650,562
Te ardhura Shpenzime interesa	lekë	-917,711	-3,852,221
Te ardhura Shpenzime te tjera financiare		808,895	-
Totali		-1,648,267	-8,502,783

26 Fitimi/humbja e vitit	Monedha	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
		Vlefëta ne lekë	Vlefëta ne lekë
Fitimi para tatimit	lekë	347,574,481	277,018,433
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	lekë	-52,592,285	-41,990,503
Fitimi/humbja e ushtrimit		294,982,196	235,027,930